



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2610/5 prot

Datë 24.11.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1234/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-80869-09-21-2023 me objekt “Blerje paisje mobilerie për shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm (Shkolla "Edith Durham" dhe Shkolla "Shejnaze Juka ” me fond limit 7,401,784.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Klame” SHPK Nipt K21518003F  
*Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati i dyte Tiranë*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkoder  
*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 - Shkodër*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni

4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi ankesën e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 22-09-2023 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-80869-09- 21-2023 me objekt “Blerje paisje mobilerie për shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm (Shkolla "Edith Durham" dhe Shkolla "Shejnaze Juka ” me fond limit 7,401,784.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder

II.2. Në datën 25.10.2023 , nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me

numër ankimi elektronik A/2023/3534 dhe me nr. 2610/2023 prot., datë 25.10.2023 e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, për procedurën e prokurimit të mësipërm, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2610/2 prot Datë 26.10.2023, janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik “Klame” SHPK ngre pretendime

II.4 Me shkresën nr. 16386 prot, datë 08.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 2610/3 prot datë 10.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor ka refuzuar atë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së mësipërme konstatohet, se formulari i ankesës së dorëzuar është me të meta, pasi mungon një diference në pagesën e kryer në dokumentin bankar ku në të vërtetohet pagesa e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

II.5 Me shkresën nr.2610/4 prot., datë 15.11.2023 Komisioni Prokurimit Publik në fomë komunikimi elektronik dhe shkresor dërgon shkresën me Lënde: Kërkesë për pagesë tarife (Diference) Drejtuar operatorit ekonomik “KLAME” SHPK *“Ne datën 25 Tetor 2023 është kryer pagesa në vlerën prej 19,362 leke në llogarinë Dega e Thesarit Tirane (kodi i te Ardhurave 4662107; Kodi i institucionit 1090001) pranë Bankës Kombëtare Tregtare, për ankesën elektronike me nr. A/2023/3534, si dhe nr. Prot., 2610/2023 datë 25.10.2023 e operatorit Klame shpk për procedurën e prokurimit me REF-80869-09-21-2023, me objekt "Blerje pajisje mobilerie për shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm (Shkolla "Edith Durham" dhe Shkolla "Shejnaze Juka"), me fond limit 7,401,784 leke, me autoritet kontraktor, Bashkia Shkoder. Në zbatim të pikës 2, germa b, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 20.04.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", operatori ekonomik Klame shpk duhet të paguaje 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet, pasi objekti i ankesës tuaj është kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. Jeni të lutur të kryeni pagesën për diferencën e mbetur në vlerën prej 17,647 leke në llogarinë Dega e Thesarit Tirane (kodi i te Ardhurave 4662107; Kodi i institucionit 1090001).”*

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të dosjes si edhe informacionit të autoritetit kontraktor

### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik në datë datën 25.10.2023 , nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3534 dhe me nr. 2610/2023 prot., datë 25.10.2023 e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, për shfyqezimin e skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues në pagesën e kryer të tarifës financiare për ankesën e mësipërme, konstatohet se ka një diferencë pa paguar, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.*

*Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

*3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*

*4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”*

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

*“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

*a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.*

III.1.2 Ne nenin 111 ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

#### **Paraqitja e ankesës**

1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.2. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e **tarifës përkatëse** për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex

specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pas dërgimit të kërkesës për pagesën e tarifës (Diferencës), ku KPP ka njoftuar me datë 15.11.2023 operatorin ekonomik ankimues përmes komunikimit elektronik dhe shkresor në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht diferenca pagesës së tarifës së ankesës, pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk rezulton të jetë administruar përgjigje e operatorit ekonomik lidhur me pagesën e diferencës të cilën duhet të paguante.

III.1.3. Në këto kushte Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme. Fakti që nuk ka korrigjuar të metat e ankesës, si në rastin konkret (diferencën) pagimit e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, i dha mundësinë operatorit ekonomik ankimues, që në rast se nuk kishte marrë dijeni nga autoriteti kontraktor për plotësimin e të metave, të mund të plotësonte këto të meta deri në datë 17.11.2023 kjo referuar ligjit 162/2020 të LPP, , por operatori ekonomik ankimues, dështoi në plotësimin e tyre.

Referuar arsyetimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar (diferencën) prej 17,647 lekë e tarifës financiare të ankesës si dhe ka refuzuar ndreqjen e të metave sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni gjykon, se ankesa operatorit ekonomik “KLAME” SHPK nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK, për procedurën e prokurimit E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-80869-09- 21-2023 me objekt “Blerje paisje mobilerie për shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm (Shkolla "Edith

Durham" dhe Shkolla "Shejnaze Juka " me fond limit 7,401,784.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 02-10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të kryejë derdhjen në Buxhet Shtetit të tarifës së paguar prej 19,362 lekësh nga operatori ekonomik "Klame" SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**